



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-061

Prishtinë, më 18 prill 2012, në orën 12:00

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 18 PRILL 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.
Mungoi, me arsye, Enis Kervan, nënkryetar i Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri dhe Emrush Haxhiu.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Propozim-vendimi për lejin me mbushje të telefonisë mobile Vala për zyrtarë,
2. Propozim-vendimi për avancim të koeficientit për disa pozita të shërbyesve civil,
3. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Organogramit të Administratës së Kuvendit, sipas Projektit të Binjakëzimit
4. Propozimi për ndarjen e zyrave në Anexin e Kuvendit.

1. Propozim-vendimi për lejin me mbushje të telefonisë mobile “Vala 900” për zyrtarë- shërbyes civil

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-vendimin e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

1. Zyrtarët-shërbyes civil të Administratës së Kuvendit të përfshihen në Vendimin për mbushje të telefonisë mobile “Vala 900” dhe atë për:
 - Koordinatorët e komisioneve parlamentare20,00 Euro në muaj,
 - Zyrtarët tjerë që nuk kanë qenë të përfshirë 5,00 Euro në muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit që të ndërmerr veprime për zbatim të këtij vendimi.

2. Propozim-vendimi për avancim të koeficientit për disa pozita të shërbyesve civil

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-vendimin e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

1. Zyrtarët-shërbyes civil të Administratës së Kuvendit me koeficient 5, avancohen në koeficient 6, në pajtim me Vendimin e Kryesisë Nr. 03-V-334 të datës 12.10.2010 dhe sipas vlerësimit vjetor në dy vitet e fundit.
2. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit që të ndërmerr veprime për zbatim të këtij vendimi.

3. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Organogramit të Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-vendimin e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohen ndryshimet dhe plotësimet e Organogramit të Administratës së Kuvendit, sipas Projektit të Binjakëzimit, me të cilit krijohen:
 1. Zyra e Sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit,
 2. Drejtoria për prokurim, nën autoritetin e Sekretarit të Kuvendit,
 3. Drejtoria për hulumtime, bibliotekë dhe arkiv.
2. Dy Departamentet aktuale riemërtohen në Drejtori të përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale dhe Drejtori e Përgjithshme për Administratë, ndërsa Divizionet aktuale riemërtohen në Drejtori të lëmive të caktuara, në kuadër të Drejtorive të përgjithshme.
3. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit që të ndërmerr veprime për zbatim të këtij vendimi.

4. Propozimi për ndarjen e zyrave në Anexin e Kuvendit

Kryesia vendosi që kjo çështje të shqyrtohet në takimin e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **13:00** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Departamenti për Çështje Ligjore dhe Procedurale